



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:142938
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05804332

KP.nr. 25/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike paditësit “EKI H Residence “ Sh.p.k me NUI 811278101 me seli në rrugën “Dëshmorët e Kombit” p.n Ferizaj të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Besmir Rahmani me seli në Ferizaj ndaj të paditurit “Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” Sh.p.k me NUI 8112888887 me seli në bulevardin “Bill Klinton” p.n Prishtin, me objekt kontesti shpërblimi i dëmit material, jashtë seancës me datën 10.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerçiale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, shpallet JO KOMPETENT në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështjen kontestimore të paditësit “EKI H Residence “ Sh.p.k ndaj të paditurit “Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” Sh.p.k, me objekt kontesti shpërblim i dëmit material.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj t’i dorëzohet Departamenti për Çështje Ekonomike pranë kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Paditësit “EKI H Residence “ Sh.p.k me seli në Ferizaj, përmes të autorizuarit të tij, me datën 20.05.2024 pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për shpërblimin e dëmit material ndaj të paditurës “Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” Sh.p.k

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, vlerësoj se Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerçiale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, mbështetur në nenet 13, par 1. lidhur me par.1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15).

Në këtë çështje juridike, gjykata vlerëson se objekt i kontestit është shpërblimi i dëmit material në mes të shoqërive tregtare, kompetente për shqyrtimit e kësaj çështje është Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, kjo bazuar në nenin 13, par.1 nën par.1.1 i Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) i cili përcakton “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: par. 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;” lidhur me par. 2 që përcakton se: “2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 17 dhe 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj, bazuar në 13, par. 1, nën par. 1.7 lidhur me par. 2 dhe 3 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenin 17, 19, 29, 387 par. 1 pika (u) dhe nenit 392 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.25/24, datë 10.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.